



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

SHKOLLË VERORE “DANUBE SUMMER SCHOOL 2015”

NË GJERMANI, 27 SHTATOR - 2 TETOR 2015

Akademia Evropiane e Danubit në bashkëpunim me disa universitete të rajonit të Danubit organizon për herë të dytë Shkollën Verore të Danubit, në të cilën do të marrin pjesë rreth 25 studentë dhe profesionistë të rinj nga mbarë rajoni i Danubit dhe jashtë saj, në datat 27 shtator - 2 tetor 2015, në Ulm / Neu-Ulm ((Vöhl Castle, City Hall Ulm).

Shkolla Verore e Danubit është një program vjetor afatshkurtër studimi për studentët pasuniversitare dhe profesionistëve të rinj, të cilët dëshirojnë të mësojnë dhe të diskutojnë me akademikët dhe vendimmarrësit faktet, sfidat dhe projektet e rajonin e Danubit.

Në vitet e ardhshme, “Danube Summer School 2015” parashikohet të jetë një modul i rregullt i programit “Master i Studimeve të Danubit (MDS)”. Studentë dhe profesionistë të rinj të huaj do të ftohen së shpejti në një konferencë të veçantë “Danube Summer School, DSS”, e cila do të prezantojë një platformë të plotë për diskutimet e ekspertëve të rinj të Danubit.

Qëllimi i kursit është ngritja rrjetit mes kërkuesve dhe krijuesve të politikave për shkëmbimin dhe diskutimin e sfidave dhe të mundësive në rajonin e Danubit. Ndër temat e rëndësishme që do të diskutohen në këtë kurs veror do të jenë:

- Zona makro-rajonale e Danubit dhe karakteristikat e tregut;
- Politikat e BE-së dhe Strategjia e Rajonit Evropian e Danubit;
- Projektet e menaxhimit dhe të financimit ndërkufitar në rajonin e Danubit;
- Migrimi dhe rrjedhja e trurit në zonën e Danubit.

Kushtet e aplikimit:

Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të aplikojnë për këtë kurs duhet të kenë interes të fortë në Rajonin e Danubit, të jenë studentë pasuniversitarë ose studentë në vitet e fundit të studimeve universitare ose profesionistë të rinj. Kandidatët duhet të kenë njohuri shume të mira të gjuhës angleze dhe të jenë në moshën 20-30 vjeç.

Programi mbulon shpenzimet e akomodimit dhe të ushqimit. Ndërsa shpenzimet e udhëtimit do të mbulohen nga vetë pjesëmarrësit. Afati i fundit për aplikim është data **31 korrik 2015.**

Për më tepër informacion lidhur me programin e këtij kursi veror, si dhe kushteve për pjesëmarrjen referojuni adresave në vijim: www.danubesummerschool.eu; info@danubesummerschool.eu;

*Europäische Donau-Akademie gemeinnützige GmbH
Schillerstraße 1
89077 Ulm,
Germany*

DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE